KLUBI I PRODHUESVE TË KOSOVËS
KOSOVO MANUFACTURING CLUB

KLUBI I PRODHUESVE

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale

Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

PËRMBAJTJA **FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E TË ARDHURAVE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	3
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	4
SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE	5

AUDIT & CONSULTING ASSOCIATES

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Menaxhmentit të Klubit të Prodhuesve

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të Klubit të Prodhuesve, që përfshinë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2020, Pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe Pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha çështjet materiale pozicionin financiar të Klubit të Prodhuesve më 31 Dhjetor 2020, dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin që ka përfunduar në përputhshmëri me Ligjet aktuale ne fuqi.

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me ligjet aktuale në fuqi dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësinë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse,

individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajëm skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimin të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.

- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërin e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.

- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit te vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmentit, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri material ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.

Armend Osaj – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
Mars, 2021

ACA Audit & Consulting Associates - sh.p.k. PRISHTINË

KLUBI I PRODHUESVE
Pasqyra e Pozitës Financiare
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

	Shënimi	31 Dhjetor 2020 (në EUR)	31 Dhjetor 2019 (në EUR)
Asetet			
Asetet jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	3	23,339	17,238
Totali i aseteve jo-qarkulluese		23,339	17,238
Asetet qarkulluese			
Llogaritë e arkëtueshme	4	45,087	27,317
Të arkëtueshmet tjera		581	581
Parapagimet		3,746	1,700
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	5	27,689	33,184
Total asetet qarkulluese		77,102	62,782
TOTAL ASETET		100,441	80,020
DETYRIMET DHE EKUITETI			
Detyrimet rrjedhëse			
Llogaritë e pagueshme	6	63,275	19,308
Obligimet tatimore	7	1,144	1,138
Totali i detyrimeve rrjedhëse		64,420	20,446
Ekuiteti			
Kapitali		-	-
Mbetjet nga vitet e kaluara		59,574	74,277
Mbetjet nga viti aktual		(23,552)	(14,704)
Totali i ekuitetit		36,021	59,574
TOTALI I DETYRIMEVE DHE EKUITETIT		100,441	80,020

Pasqyrat financiare janë nënshkruar në Mars 2021 nga:

Astrit Panshë
Drejtor Ekzekutiv

Emine Peci Mahmuti
Zyrtare financiare

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

KLUBI I PRODHUESVE
Pasqyra e të ardhurave
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

	Shënimi	Fundi vitit 31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	Fundi vitit 31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Të hyrat			
Të hyrat	**8**	135,953	127,919
Të hyrat nga grantet	**9**	16,000	137,300
Totali i të hyrave		**151,953**	**265,219**
Shpenzimet			
Shpenzimet e administratës	**10**	82,338	46,592
Shpenzimet e programit	**11**	11,804	48,656
Pagat dhe benefitet	**12**	74,883	82,944
Shpenzimet per projekte	**13**	700	93,908
Shpenzimet e zhvleresimit		5,109	2,969
Shpenzime tjera operative		672	4,854
Total i shpenzimeve		**175,506**	**279,923**
Fitimi para tatimit		**(23,552)**	**(14,704)**
Tatimi 10%		-	-
Pjesa e mbetur		**(23,552)**	**(14,704)**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

KLUBI I PRODHUESVE
Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
Për fundin e vitit më 31 Dhjetor 2020

	Kapitali Aksionar (në EUR)	Fitimi/(Humbja) e bartur (në EUR)	Totali i Ekuitetit (në EUR)
Bilanci më 01 Janar 2019			
Saldoja e bartur	-	74,277	74,277
Mbetja e vitit	-	(14,704)	(14,704)
Korigjimet për periudhen paraprake	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2019	**-**	**59,574**	**59,574**
Bilanci më 01 Janar 2020			
Saldoja e bartur	-	59,574	59,574
Mbetja e vitit	-	(23,552)	(23,552)
Korigjimet për periudhen paraprake	-	-	-
Bilanci më 31 Dhjetor 2020	**-**	**36,021**	**36,021**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

	Fundi vitit 31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	Fundi vitit 31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operuese		
(Deficiti)/mbetja për periudhën	(23,552)	(14,704)
Korrigjimet për periudhën paraprake	-	-
Rregulluar për:		
Zhvlerësimi	5,109	2,969
Ndryshimet në të arkëtueshme	(17,770)	3,350
Ndryshimet në parapagime	(2,046)	-
Ndryshimet në të pagueshme	43,968	(6,956)
Ndryshimet në detyrimet në tatimore	6	(589)
Paraja neto nga aktivitetet operuese	**5,715**	**(15,930)**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerja e pronës dhe e paisjeve	(11,210)	(13,379)
Paraja neto e përdorur në investime	**(11,210)**	**(13,379)**
Ndryshimet neto në para dhe ekuivalent	**(5,495)**	**(29,309)**
Paraja dhe ekuivalentet e parasë më 1 Janar	33,184	62,493
Paraja dhe ekuivalentet më 31 Dhjetor	**27,689**	**33,184**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 14 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

1. HYRJE

Qëllimet kryesore të Klubit janë të zhvillojë forume dhe takime që nxisin diskutim dhe bashkëpunim në mes të anëtarëve dhe institucioneve shtetërore për zhvillimin e sektorit të prodhimit, të organizojmë aktivitete në bashkëpunimi me institucionet shtetërore dhe private me qëllim fuqizimin dhe promovimin e prodhimeve Made in Kosova, të vetëdijësojmë qytetarët për rolin pozitiv që konsumi i prodhimeve vendore luan në zhvillimin ekonomik të vendit

Klubi i Prodhuesve të Kosovës vepron dhe realizon aktivitetet mbi katër shtylla themelore:

Avokimi, përmes së cilës Klubi synon të ndikoj tek institucionet përkatëse për të avancuar dhe përmirësuar politikat ndaj prodhuesve vendor.
Bashkëpunimi me të gjithë akterët relevant, Klubi do të jetë shumë aktiv në zhvillimin e frymës bashkëpunuese me të gjithë akterët për çështjet qe ndërlidhen me prodhuesit vendor.
Promovimi i produkteve Made in Kosova si brenda ashtu edhe jashtë vendit.
Vetëdijësimi dhe mbrojtja e konsumatorit, Klubi synon që përmes aktiviteteve të ndryshme të rrit njohuritë e përgjithshme në mesin e konsumatorëve në lidhje me rëndësinë e konsumit të produkteve vendore dhe njëkohësisht të zhvillojmë mekanizmat e mbrojtjes se konsumatorit.

2. BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare për Organizatën janë përgatitur në bazë të kontabilitetit në bazë të keshit për të hyrat dhe shpenzimet. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

2.2 Valuta e përdorur

Valuta funksionale e Organizatës është valuta e Bashkimit Evropian Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

2.3 Shkëmbimi i valutës së huaj

Transaksionet në valutë të huaj janë shkëmbyer në monedhën funksionale duke përdorur kursin e këmbimit ekzistues në datat e transaksioneve. Fitimet dhe humbjet në valutat e huaja që rezultojnë nga rregullimet e transaksioneve të tilla si dhe nga ri-matjet e zërave monetar me kurset e këmbimit të fund vitit paraqiten si fitim ose humbje.

2.4 Prona, impiantet dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Prona, toka dhe pajisjet e biznesit janë deklaruar në pasqyrën e pozicionit financiar me koston historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e dëmtimit në vlerë.

Makineria dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre minus zhvlerësimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga rënia e vlerës se tyre. Zhvlerësimi njihet në mënyrë që të anulojë koston apo vlerësimin e mjeteve minus vlerat e mbetura mbi dobishmerinë e tyre, duke përdorur metodën lineare. Jetëgjatësia, vlera e mbetur dhe metoda e amortizimit rishikohen në çdo datë raportimi, me efektin e ndonjë ndryshimi në vlerësim, atëherë ndryshimet llogariten në periudhën e ardhshme.

Fitimi ose humbja që paraqitet me rastin e shitjes ose nxjerrjes nga përdorimi i një pasurie përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të një pasurie dhe si rrjedhojë njihet si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi i pronës, impianteve dhe paisjeve është llogaritur duke përdorur metodën drejtvizore për shpërndarjen e kostos ose koston e konsideruar tek vlera e mbetur e tyre përgjatë jetëgjatësisë së tyre të përdorimit si në vijim:

Ndërtesat	20 vite
Pajisje dhe makineri	10 vite
Pasuritë e paprekshme	5 vite

2.5 Të arkëtueshmet tregtare

Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që Organizata nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmive objketive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa.

2.6 Të arkëtueshmet tjera

Në llogaritë e të arkëtueshmeve tjera përfshihet parapagimet dhe pasuritë e tjera qarkulluese. Parapagimet mbahen me kosto minus provizioni nëse ka. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti.

2.7 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë kosideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse, si dhe paraja me maturitet jo më shume se tre muaj.

2.8 Të pagueshmet tregtare

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë.

2.9 Detyrimet kontraktuale

Detyrimet kontraktuale përfaqësojnë detyrimin e Organizatës për të transferuar mallra ose shërbimet tek një klient dhe njihen atëherë kur një klient paguan konsideratën, ose atëherë kur Organizata bënë njohjen e një të arkëtueshme me qëllim që të pasqyrojë të drejtën e pakushtëzuar të saj për shqyrtim para se Organizata të ketë transferuar mallrat ose shërbimet ndaj klientit.

2.10 Tatimet

Organizata u themelua si një organizatë joqeveritare, për këtë arsye ka përgjegjësi dhe vepron si një OJQ sipas ligjeve në fuqi të Kosovës.

2.11 Njohja e të hyrave

Të hyrat nga grantet njihen si të ardhura në periudhën kur paguhen. Në fund të vitit sasia e tepërt e të ardhurave krahas shpenzimeve trajtohen si bilanc i bartur në periudhën e ardhshme.

2.12 Shpenzimet

Shpenzimet e ndodhura janë njohur në periudhën përkatëse në baza të keshit.

2.13 Provizionet dhe detyrimet e papritura (kontingjente)

Detyrimet e papritura nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Deri më 31 dhjetor 2020, nuk ka detyrime me kusht që kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare të Organizatës. Provizioni është njohur nëse biznesi ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

2.14 Përfitimet e të punësuarve

Organizata, në rrjedhën normale të biznesit, bën pagesa në buxhetin e shtetit për llogari të puntorëve. Puntorët e Organizatës janë anëtarë të planit shtetëror të pensioneve. Të gjitha kontributet e tilla në skemat e pensioneve të detyrueshme qeveritare shpenzohen kur ato ndodhin. Organizata nuk operon asnjë skemë tjetër pensioni ose plan përfitimesh pas daljes në pension dhe, rrjedhimisht, nuk ka asnjë detyrim në lidhje me pensionet.
Për më tepër, Organizata nuk ka detyrime materiale për të siguruar përfitime të mëtejshme për puntorët paraprak dhe aktual.

3. PRONA, IMPIANTET DHE PAJISJET

	Orendi	IT Pajisjet	Software	Totali
Kostoja				
Me 1 Janar 2019	8,278	5,454	-	13,732
Shtesat	-	13,379	-	13,379
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	**8,278**	**18,833**	**-**	**27,111**
Me 1 Janar 2020	8,278	18,833	-	27,111
Shtesat	-	-	11,210	11,210
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	**8,278**	**18,833**	**11,210**	**38,321**
Zhvlerësimi i akumuluar				
Me 1 Janar 2019	4,977	1,927	-	6,904
Zhvlerësimi për vitin	1,656	1,314	-	2,969
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2019	**6,633**	**3,240**	**-**	**9,873**
Me 1 Janar 2020	6,633	3,240	-	9,873
Zhvlerësimi për vitin	1,286	3,636	187	5,109
Shitjet e mjeteve	-	-	-	-
Me 31 Dhjetor 2020	**7,919**	**6,876**	**187**	**14,982**
Shuma e bartur				
Me 31 Dhjetor 2020	**359**	**11,957**	**11,023**	**23,339**
Me 31 Dhjetor 2019	**1,645**	**15,593**	**-**	**17,238**

4. LLOGARITË E ARKËTUESHME

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Llogaritë e arkëtueshme	45,087	27,317
Total i të arkëtueshmeve	**45,087**	**27,317**

5. PARAJA DHE GJENDJA NË BANKA

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Paraja e gatshme	222	249
Paraja në bankë	27,467	32,935
Totali parasë dhe gjendjes në bankë	**27,689**	**33,184**

6. LLOGARITË E PAGUESHME

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Llogarite e pagueshme	54,951	16,856
Qiraja e pagueshme	7,300	1,700
Tjera	1,025	752
Totali i llogarive të pagueshme	**63,275**	**19,308**

7. OBLIGIMET TATIMORE

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Kontributi pensional	574	580
Tatimi ne paga i pagueshem	412	410
Tatimi ne qira i pagueshem	158	148
Totali i obligimeve tatimore	**1,144**	**1,138**

8. TË HYRAT

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Te hyra nga Antaresia	60,000	48,000
Te hyra nga Donacioni	57,089	48,379
Te hyra nga Sponsoret	9,500	31,540
Te tjera	9,364	-
Totali i të hyrave	**135,953**	**127,919**

9. TË HYRAT NGA GRANTI

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Cardno Emergining Markets USA	-	127,300
Giz	10,000	10,000
EYE (Enhancing Youth Emplayment)	6,000	-
Totali i të hyrave nga grantet	**16,000**	**137,300**

10. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Komunikimi (interneti, telefoni)	3,018	3,305
Karburant	1,527	440
Qiraja	20,330	19,780
Shpenzimet e zyrës	1,234	682
Sigurimit	-	1,725
Shpenzimet komunale	1,298	2,177
Shpenzimet Bankare	579	574
Shpenzimet e reklamimit	882	686
Shpenzimet Rent a Car	-	2,363
Web, Hosting, Domain	272	720
Sherbime ligjore	-	3,540
Sherbime te kontabilitetit	1,416	1,416
Sherbime profesionale - Other	1,180	1,180
Dekori i ambientit	-	7,335
Fushata Besa për Kosove	47,415	-
Tjera	3,188	670
Totali i shpenzimeve administrative	**82,338**	**46,592**

11. SHPENZIMET PROGRAMORE

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Përkthimi	860	-
Bileta - Airoplan	-	2,878
Conference, Convention, Meeting	1,671	14,120
Printimi	446	7,132
Udhetimit	967	3,861
Meditje	825	7,031
Shpenzimet e reprezentacionit	2,819	3,704
Mirënjohjeve	-	20
Shfrytezim i sallave	472	2,365
Xhirimeve	-	2,520
Desing & Animation	1,100	-
Tjera	2,644	5,025
Totali i shpenzimeve programore	**11,804**	**48,656**

12. PAGAT DHE BENEFITET

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Pagat Bruto	71,317	78,994
Kontributi Pensional	3,566	3,950
Totali nga pagat dhe benefitet	**74,883**	**82,944**

13. SHPENZIMET PËR PROJEKTE

	31 Dhjetor, 2020 (në EUR)	31 Dhjetor, 2019 (në EUR)
Subvencione per kompanite/pagesa per praktikante	-	89,408
Shpezimet e qiramarrjeve te ndryshme	700	4,500
Totali i shpenzimeve per projekte	**700**	**93,908**

14. NGJARJET E MËPASME

COVID-19
Periudha disamujore e mbylljes së organizatës ose reduktimit të aktiviteteve mund të ketë efekt në operimet e organizatës në të ardhmen.

Në kohën e përgatitjes së raportit të auditimit, organizata ka vazhduar operimet dhe ka qenë në gjendje t'i përmbushë obligimet, për këtë arsye raporti është përgatitë duke përdorur bazën e vijimësisë.